



Republika e Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Nr. 318 prot., Prishtinë, më 27.10 2020



Republika e Shqipërisë

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Nr. 346 prot., Tiranë, më 27.10 2020



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në fushën e shkëmbimit të të dhënave nga rrjeti i përhershëm i stacioneve GNSS
(Global Navigation Satellite System).

Në mes të:

Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Republika e Kosovës dhe Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor, Republika e Shqipërisë

Agjencia Kadastrale e Kosovës (referuar si AKK) e Republikës së Kosovës dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (referuar si ASIG) e Republikës së Shqipërisë - në vijim "palët në Marrëveshje",

Dëshirojnë të krijojnë bashkëpunim në fushën e shkëmbimit të të dhënave nga rrjeti i përhershëm i stacioneve GNSS (referuar si stacione GNSS), sipas ligjeve dhe dispozitave ligjore të shteteve të tyre, kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

- (1) Qëllimi i Marrëveshjes është krijimi i bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në fushën e shkëmbimit të të dhënave të stacioneve të përhershme GNSS.
- (2) AKK ka krijuar një rrjet të stacioneve të përhershme GNSS, të quajtur KOPOS.
- (3) ASIG ka krijuar një rrjet të stacioneve të përhershme GNSS, të quajtur ALBCORS.
- (4) Palët në Marrëveshje do të marrin përsipër shkëmbimin e të dhënave nga stacionet e përhershme kufitare të GNSS, të përfshira në rrjetet KOPOS dhe ALBCORS.
- (5) Lista e stacioneve GNSS është dhënë në Shtojcën 1, që përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes i referohen ekskluzivisht këtyre stacioneve.
- (6) Nëse lind nevoja për të kryer shkëmbimin e të dhënave nga stacione të tjera që nuk janë përfshirë në Shtojcën 1, ose në rast se shkëmbimi i të dhënave nuk kërkohet më në mes stacioneve të caktuara që janë të renditura në Shtojcën 1, palët e Marrëveshjes do të modifikojnë

listën e stacioneve që janë dhënë në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje, duke bërë modifikime me shkrim.

Neni 2 **Stacionet GNSS**

- (1) Të dy palët në Marrëveshje vendosin dhe mbajnë stacionet GNSS në territorin e vet shtetëror.
- (2) Pozicionet e stacioneve të GNSS janë përcaktuar në kuadër të Sistemit Koordinativ Referent Tokësor Evropian ETRS89.
- (3) Palët në Marrëveshje do të shkëmbejnë të dhënat e tyre të matjeve nga GNSS dhe të dhënat që përcaktojnë pozicionet e antenave GNSS, së bashku me të dhënat lidhur me kalibrimin e antenës (duke i kushtuar vëmendje kushteve të licencës), së bashku me të gjitha informatat e tjera, të nevojshme për funksionimin pa pengesa të dy rrjeteve.

Neni 3 **Pajisjet e komunikimit**


- (1) Palët në Marrëveshje do të sigurojnë, me shpenzimet e veta, pajisjet e nevojshme për komunikim, duke lehtësuar shkëmbimin ndërkombëtar të të dhënave (p.sh. linjat e marra me qira / në shfrytëzim, Internet / VPN)
- (2) Kohëzgjatja e transferimit të të dhënave nga stacionet individuale në Qendrën e Kontrollit GNSS në Prishtinë apo Tiranë duhet të jetë jo më shumë se 500 ms, ndërsa besueshmëria e aftësive funksionale të sistemit duhet të jetë jo më pak se 98%, e aplikueshme për ditë pune brenda periudhës së orarit 8 - 16.
- (3) Palët në Marrëveshje do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të siguruar që pajisjet teknike të ndjekin zhvillimin teknik, duke siguruar përputhshmërinë e tyre.
- (4) Secila nga palët do të mbulojë në mënyrë të pavarur shpenzimet e nevojshme për investime.

Neni 4 **Formati i të dhënave**

- (1) Shkëmbimi i të dhënave nga stacionet GNSS do të bëhet në formatin e të dhënave të papërpunuara, brenda intervaleve 1 sekondë.
- (2) Shkëmbimi i të dhënave për qëllime të pas përpunimit do të kryhet në formatin RINEX.
- (3) Në rast të ndryshimeve të formatit të të dhënave (për shembull, bazuar në modifikimet e programeve softuerike, etj.), palët në Marrëveshje duhet t'i komunikojnë këto ndryshime njëri-tjetrit brenda jo më pak se 6 (gjashtë) muaj para ndryshimeve që ndodhin.

Neni 5 **Pagesa e shërbimeve**

- (1) Shërbimet e shkëmbimit të të dhënave nga stacionet GNSS që janë të listuara në Shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje mbeten pa pagesë për të dy palët në Marrëveshje.



Neni 6
Përdorimi i të dhënave

- (1) Të dhënat e shkëmbyera janë në dispozicion për t'u përdorur nga palët në Marrëveshje, brenda shërbimeve të tyre të ofruara në fushën e pozicionimit.
- (2) Të dhënat origjinale (të dhënat e papërpunuara-raw) ose të dhënat RINEX nga stacionet individuale GNSS mbeten pronë e palës që ka juridiksion mbi stacionin e dhënë, dhe vetëm pala e tillë mund të përdorë të dhëna të tilla.
- (3) Për qëllime të transferimit të të dhënave origjinale tek ofruesit e tjerë të shërbimeve të pozicionimit, është e nevojshme të merret leja nga pala përgjegjëse sipas Marrëveshjes për stacionin e dhënë. Një palë e tillë gjithashtu duhet të angazhohet në negociata lidhur me shpenzimet e mundshme në lidhje me shpërndarjen e të dhënave. Ngarkesa e pagesës për të dhënat dhe shërbimet duhet të akordohet në mënyrë bilaterale midis palës që zotëron të dhënat dhe ofruesit të dytë të të dhënave.

Neni 7
Garancitë

- (1) Në rast të ndërprerjes së shkëmbimit të të dhënave GNSS, me përjashtim të neglizhencës së rëndë ose veprimit të paramenduar nga një palë në Marrëveshje që mund të provohet më vonë, palët nuk do të bëjnë asnjë kërkesë për kompensim.

Neni 8
Informimi

- (1) Palët në Marrëveshje do të informojnë njëra-tjetrën për ndërprerjet e paplanifikuara në transferimin e të dhënave dhe ndryshimet e bëra në stacionet GNSS, sidomos zëvendësimin e planifikuar të pranuesit të stacioneve GNSS. Palët duhet të sigurojnë kohë të mjaftueshme për fazën testuese në qendrat e tyre.
- (2) Palët në Marrëveshje njoftojnë njëra-tjetrën çdo 6 muaj për ndryshimet e planifikuara teknike dhe ndryshimet e tjera në rrjetin e stacioneve GNSS.

Neni 9
Zbatimi

Departamentet përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje janë Drejtoria e Gjeodezisë dhe Hartografisë në ASIG dhe Drejtorati për Gjeoinformacion në AKK.



Neni 10
Transparenca

(1) Palët në Marrëveshje do të bëjnë përpjekje për të ndërmarrë veprime të nevojshme në marrëdhëniet me publikun në lidhje me shërbimet e pozicionimit satelitor.

(2) Palët në Marrëveshje do ta publikojnë këtë kopje të marrëveshjes, si dhe kushtet e plota teknike dhe të shkëmbimit të të dhënave në faqet e internetit të rrjeteve KOPOS dhe ALBCORS.

Neni 11
Kohëzgjatja, përfundimi dhe pasojat juridike të kësaj Marrëveshjeje

(1) Kjo Marrëveshje është bërë për një periudhë pesëvjeçare, më pas vazhdohet pa procedurë për një vit tjetër, përveç nëse ndonjë palë në Marrëveshje e përfundon Marrëveshjen brenda afatit të njoftimit prej gjashtë muajsh.

(2) Të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje mund të transferohen tek personi i tretë sipas pëlqimit të dhënë nga të dy Palët në Marrëveshje.

Neni 12
Dispozitat përfundimtare

(1) Kjo Marrëveshje do të bëhet e vlefshme në ditën e nënshkrimit.

(2) Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet ose të shtohet vetëm duke ndjekur pëlqimin e ndërsjellë të Palëve në Marrëveshje, të dhënë në formë të shkruar.

(3) Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet në mënyrë miqësore nga palët në Marrëveshje brenda konsultimeve dhe negociatave.

Nënshkruar më 28.10.2020 në TIRANË në dy (2) kopje, në gjuhën shqipe, ku dokumentet janë njësoj të besueshme.

REPUBLIKA E KOSOVËS
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS

DREJTORI EKZEKUTIV


Avni Ahmeti

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI SHTETËROR PËR
INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR

DREJTORI I PËRGJITHSHËM


Lorenc Çala

Shtojca 1:

Stacionet GNSS të përfshira në shkëmbimin e të dhënave ndërmjet KOPOS dhe ALBCORS

Institucioni përgjegjës	Stacionet referente GNSS	Vërejtje
REPUBLIKA E KOSOVËS AKK	Pejë Rahovec Dragash	E vendosur E vendosur E vendosur
REPUBLIKA E SHQIPËRISË ASIG	Bajram Curr Kukës Peshkopi	E vendosur E vendosur E vendosur

Republika e Kosovës

Agjencia Kadastrale e Kosovës

Personi Kontaktues:

Reshat Murati,

E-mail: reshat.murati@rks-gov.net

Telefoni: +383 38 512 663

Republika e Shqipërisë

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Personi Kontaktues:

Bledar Sina,

E-mail: Bledar.Sina@asig.gov.al

Telefoni: +355 692735526